



E Ngarkuara e Qeverisë Federale
për Migracionin, Refugjatët
dhe Integrimin

ÇFARË DUHET TË DINI TANI MBI KORONAN

Këshilla për sjelljen, kodi i punës dhe rregullat
në lidhje me udhëtimin me një shikim

Këtu gjeni
informacione mbi App
paralajmërues të koronas së
qeverisë federale në gjuhën
Tuaj amtare.



[www.integrationsbeauftragte.de/
corona-warn-app](http://www.integrationsbeauftragte.de/corona-warn-app)

E rëndësishme:
Me një vaksinë kundër
Koronas ju mbron veten
dhe të tjerët



[www.integrationsbeauftragte.de/
corona-virus](http://www.integrationsbeauftragte.de/corona-virus)

Shëndeti




SI MUND TË MBROJ VETEN DHE TË TJERËT?

Të gjithë mund të ndihmojnë, për ta luftuar koronavirus. Mbajini kontaktet me njerëzit e tjerë mundësisht të vogla dhe kufizohuni në një rreth personash, i cili nuk ndryshon. Vetëm kështu mund të mënjanonin infektimin. Gjithmonë e rëndësishme:



Që të lani duart
(minimumi për
20 sekonda)



Mbani të 1,5 metra
distancë kundrejt
njerëzve të tjerë.



Mbani një mbulesë
për gojën dhe
hundën.



Kollitni ose teshtini
në këndin e bërrylit
ose në një facoletë.



Ajrosni mjaftueshë
ambientet e mbyllura.



PSE DUHET TË VAKSINOHEM KUNDËR KORONAVIRUSIT?

- Ju mbron veten, të afërmit tuaj dhe personat e kontaktit.
- Vaksina është më dëshirë dhe falas. Në numrin e telefonit 116 117 informoheni se kur mund të vaksinoheni.
- Vaksinat u kontrolluan me kujdes për sa i përket tolerancës, sigurisë dhe efektivitetit.



ÇFARË DUHET TË BËJ, NËSE BESOJ QË JAM INFEKTUAR?

Keni pasur kontakt personal me një person, te i cili u vërtetua që ishte i infektuar me koronavirus? Telefononi menjëherë zyrën tuaj të shëndetit! Edhe atëherë, nëse nuk dallohen shenja të sëmundjes. Në numrin e telefonit 116 117 ju informoheni se ku mund të testoheni. Deri sa të mbërrijë rezultati, ju qëndroni në shtëpi!

JETA PUBLIKE



Në hapësirën publike vlen: Mbani një distancë minimale prej 1,5 m. Në transportin publik brenda qytetit, gjatë kryerjes së pazarit dhe në të gjitha klasat në shkollë është në fuqi detyrimi i mbajtjes së maskës.

Në transportin publik brenda qytetit ju duhet të vërtetoni, që jeni i vaksinuar, i shëruar ose jeni testuar negativ (rregulli 3G).

Kushtet për testin: Testi i shpejtë antigjen (maks. 24 orë i vjetër) ose testi PCR (maks. 48 orë i vjetër). Të përjashtuar janë të fëmijët deri 6 vjeç dhe fëmijët që shkojnë në shkollë.

Për të bërë pazare, në restorante, bare, hotele ose në teatër lejohen të shkojnë vetëm të shëruarit nga Corona ose të vaksinuarit plotësisht (2G). Dyqanet për nevojat e përditshme (për shembull supermarketet, farmacitë, dyqanet për shitjen e detergjenteve dhe produkteve estetike, libraritë) mbeten të hapura për të gjithë.

Testet e shpejta të rregullta Corona janë një pjesë përbërëse e rëndësishme për më shumë siguri: Ju mund të bëni falas të paktën një herë në javë një test të shpejtë.

Takimet private me të pa vaksinuarit ose me personat e shëruar, janë të kufizuara me pjesëtarët e familjes dhe maksimumi dy persona nga një familje tjetër. Fëmijët deri në 14 vjeç janë të përjashtuar.

Në landet federale janë të mundura ose kanë hyrë tashmë në fuqi edhe rregulla më të rrepta dhe kufizime të kontakteve për të pa vaksinuarit.

Informacione mbi këtë gjë ka në faqet e landeve.

Puna dhe paratë



CILAT RREGULLA VLEJNË NË VENDIN E PUNËS?

Në vendin e punës ju duhet të vërtetoni, që jeni i vaksinuar, i shëruar ose jeni testuar negativ (3G). Ju mund të testoheni edhe në vendin e punës, i monitoruar. Punëdhënësi juaj duhet ta kontrollojë këtë gjë. Nëse nuk punoni vetëm në home office, punëdhënësi juaj duhet t'ju ofrojë të paktën dy herë në javë teste personale ose të shpejta. Edhe në vendin e punës është në fuqi detyrimi i mbajtjes së një maske, nëse nuk mund ta ruani në mënyrë të sigurt distancën 1,5 m. Punëdhënësi juaj duhet t'ju ofrojë juve mundësinë të punoni nga shtëpia, nëse nuk ka arsye të rëndësishme operationale që e kundërshtojnë një gjë të tillë.

ÇFARË DUHET TË BËJ, NËSE NGELEM PA PUNË?

Ju duhet të regjistrohni në Jobcenter-in tuaj ose zyrën tuaj të punës. Të dyja presin vizitorë por vetëm në raste urgjente dhe duke caktuar një takim. Ju mund të regjistrohni si i papunë me telefon, me letër ose online. Kërkesat mund ti parashtroni edhe online. E rëndësishme është: Rregullat e mbrojtjes kundrejt largimit nga puna

vazhdojnë të jenë në fuqi. Përveç kësaj u thjeshtua aksesit kundrejt siguracionit bazë për personat që kërkojnë punë.



ÇFARË NDODH, NËSE PUNËDHËNËSI IM KA URDHËRUAR PUNË ME ORAR TË SHKURTUAR?

Ju mund të përfitoni deri në 24 muaj pagesën për punë me orar të shkurtuar. Mund të jetë deri në 87% të pagës tuaj të munguar. Nëse janë përmbushur të gjitha kushtet, kontrollohet për çdo rast nga agjencia e punës.



ÇFARË NDIHMASH MUND TË MARR PËR NDERMARRJEN TIME?

Ndërmarrjet e pavarura, të cilët janë në një situatë të vështirë financiare për shkak të Corona-s, mund të kërkojnë kredi të favorshme, grante dhe garanci. Se çfarë është e mundur, e tregon ky gjetës vendimmarrjesh:

<https://www.bmwi.de/Redaktion/DE/Module/Entscheidungsfinder/entscheidungsfinder.html>





MUND TË PARASHTRONJ KËRKESËN PËR NJË SHITESË PËR FËMIJËT?

Nëse të ardhurat tuaja nuk mjaftojnë për të gjithë familjen, ekziston mundësia e një ndihme financiare.

A MUND TË KERKOJ PAGESË PER SËMUNDJEN E FEMILJËVE?

Në vit ju mund të përfitoni 30 ditë pagesë kur fëmijët janë sëmurë, për çdo prind (60 ditë, nëse ju e rrisni fëmijën e/i vetme/vetëm). Kjo vlen edhe në rastin kur ju duhet të kujdeseni për fëmijën tuaj në shtëpi, pasi shkolla ose kopshti janë mbyllur për shkak të pandemisë.



ÇFARË VLEN PËR UDHËTIMET?

Udhëtimet private dhe turistike brenda dhe jashtë vendit, të cilat nuk janë të domosdoshme, duhet që të vazhdojnë të mos kryhen. Ju lutemi informohuni para udhëtimit tuaj në një vend të huaj pranë ministrisë së jashtme dhe pranë ministrisë së brendshme mbi kufizimet aktuale të udhëtimit dhe kontrollet në kufi.

ÇFARË DUHET TË KEM PARASYSH KUR TË KTHEHEM?

Kush vjen në Gjermani nga një zonë me rrezik të lartë ose me variante të virusit, duhet që para udhëtimit të plotësojnë një regjistrim digjital të udhëtimit. Para çdo udhëtimi nga një vend tjetër është i domosdoshëm një vërtetim vaksinimi, testi ose shërimi. Kjo vlen për të gjithë personat që kanë mbushur 12 vjeç e lart. Testi mund të jetë test PCR ose antigjen.

Parimisht, të gjithë personat janë të detyruar të qëndrojnë në karantinë në shtëpi për 14 ditë, nëse udhëtimi bëhet nga një zonë me variante të virusit. Në rastin e udhëtimit nga një zonë me rrezik të lartë karantina zgjat 10 ditë. Megjithatë, personat e vaksinuar plotësisht kundër koronavirusit ose

personat që e kanë kaluar virusin nuk duhet të futen në karantinë. Personat që gjatë udhëtimit të kthimit nga një zonë me rrezik të lartë janë testuar negativ mund ta përfundojnë karantinën duke filluar nga dita e 5-të me një test tjetër. Si provë për shërimin vlen një test laboratorik (PCR, PoC-PCR) i cili është kryer minimumi para 28 ditësh ose maksimumi para 6 muajsh. Vaksinimi i plotë duhet të jetë kryer të paktën 14 ditë më parë.

Se ku mund të testoheni e merrni vesh në numrin e telefonit 116 117.

Kujdes: Në rast mosrespektimi të detyrimit të karantinimit, do të gjobiteni.

Shtetet që klasifikohen si zonë me rrezik të lartë ose me variante virusi i gjeni këtu: https://www.rki.de/DE/Content/InfAZ/N/Neuartiges_Coronavirus/Risikogebiete_neu.html



KU MUND TË GJEJ INFORMACIONE TË BESUESHME MBI KËTO TEMA NË GJUHË TË NDRYSHME?

Interneti është plot me thashetheme dhe fake news, të cilat përhapen me shpejtësi nëpërmjet chat-eve në grup.

Informacione aktuale në gjuhë të ndryshme, të cilave ju mund ti zini besë, gjeni në: www.integrationsbeauftragte.de/corona-virus dhe www.eu-gleichbehandlungsstelle.de/corona-virus

Botuesi:

E Ngarkuara e Qeverisë Federale për Migracionin, Refugjatët dhe Integrimin

Versioni:

02.12.2021



www.integrationsbeauftragte.de/corona-virus



www.eu-gleichbehandlungsstelle.de/corona-virus